

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

B360

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

L11311041A

NUIS/NIPT

Rruga Abdi Toptani, Pallati Torre Drin, Kati 6, Ap. 64.

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0682023535

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

a.frangu@b360.al

E-mail

administrator Armand Frangu

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2023/07/18

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

+355682023535

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-74792-07-11-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Local

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.

Operatori i Sistemit të Transmetimit OST

Vlera e përlogaritur e prokurimit

Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

38200000

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Upgrade Hardware-Software i sistemit të kontrollit të nënstacionit 220 kV Babicë

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/07/27

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/07/27

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/51124/07112023

32428000-9

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

LPP dhe VKM

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të këtij prokurimi, shoqëria jonë me anë të kësaj ankese kundërshton pjesërisht kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike të dhëna, pasi ato nuk janë hartuar plotësisht në përputhje me Ligjin e Prokurimeve Publike.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Më 12.07.2023 jemi njohur nga portali APP.GOV.AL me procedurën e prokurimit që do të zhvillohet nga autoriteti kontraktor Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), me objekt të kontratës “Upgrade Hardware-Software i sistemit të kontrollit të nënstacionit 220 kV Babcë”.

Në bazë të Nenit 110 të Ligjit të Prokurimeve Publike 162/2020 (më poshtë do i referohemi thjeshtë LPP), dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 për Rregullat e Prokurimit Publik (më poshtë do i referohemi thjeshtë VKM Nr.) paraqesim këtë ankese në lidhje me procedurën e prokurimit në fjalë.

ANKESA 1

A.

Në kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti teknik, paragrafi 2.3.4, AK ka kërkuar:

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues, për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi, duhet të ketë numer punonjesh jo më të vogël se 10 (dhjetë), ku të paktën 7 (shtatë) nga këta punonjës të jenë të diplomuar në Shkencë Elektronike / Teknologji Informacioni / Informatikë / Informatikë Ekonomike / Telekomunikacioni. Për të vertetuar aftësitë dhe kapacitetet teknike, stafi duhet të jetë i pajisur dhe me certifikatat, si më poshtë:

? Te paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar për Menaxhim Projekt.

? Te paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar si Ethical Hacker (CEH ose ekuivalent).

? Te paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar në implementimin dhe menaxhimin e sistemeve të sigurisë së informacionit (CISM ose ekuivalent).

? Te paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar në rrjetet kompjuterike CCNA ose ekuivalent.

? Te paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar si Manager i Sistemeve IT (ITIL ose ekuivalent).

? Te paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar menaxhimin e sigurisë dhe riskut në sistemet e sigurisë (CRISK ose ekuivalent).

? Te paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar dhe trajnuar nga entiteti i njohur ndërkombëtar apo vendas, për lead auditor 27001 për Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit.

Ajo që vërehet është se kërkohen 9 certifikime, nga të cilat njëra është për menaxhim projekt dhe 8 të tjera për menaxhim të sistemeve IT, kryesisht të lidhura me sigurinë kibernetike.

Ndërkohë i gjithë projekti është për përditësimin dhe/ose instalimin e një sistemi të menaxhimit të rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike dhe ka komponentë softueri SCADA, sistemi operimi, servera, invertera, etj. AK nuk ka kërkuar absolutisht asnjë certifikatë profesionale për këto sisteme por është fokusuar kryesisht në sigurinë kibernetike.

Kemi bindjen që numri dhe tipi i certifikatave profesionale që ka vënë si kriter kualifikimi AK-ja, është i ekzagjeruar për vetë natyrën dhe madhësinë e projektit. Do të instalohet një softuer SCADA dhe për këtë 2-3 certifikata profesionale të lidhura me standardet e sigurisë kibernetike do të mjaftonin. Secila nga certifikatat e kërkuara ka prerje të fortë në përmbajtjen e saj dhe arsyen se përse kërkohen në projekt me të paktën 2 certifikata të tjera.

Dy kërkesa në veçanti janë të ekzagjeruara:

? Te paktën 2 (dy) punonjes të certifikuar si Ethical Hacker (CEH ose ekuivalent).

Përse do të duhen në projekt dy “Hekërsa me Etikë” për të testuar sistemin për sulmet kibernetike.

Çfarë do bënte hekërsi i dytë që nuk e bën i pari “hekërs me etikë” i certifikuar? Ndërkohë që duhet theksuar që “hekërsi me etikë” do jetë i asistuar nga një auditor Lead-Auditor 27001, që është një certifikatë profesionale e nivelit shumë të lartë për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit. Po kjo nuk ndalet këtu. AK-ja po e blinda “hekërsin me etikë” dhe Lead-Auditorin 27001 edhe me një certifikatë tjetër të lartë për menaxhimin e sigurisë së informacionit që është CISM.

Ngjan sikur softueri i menaxhimit të rrezeve elektrike në nënstacionet e Babicës apo Tiranës duhet të jetë i një sigurie jashtëzakonisht të lartë kibernetike dhe ai duhet të monitorohet nga një skuadër super eksperte për sigurinë kibernetike. E gjithë logjika e AK-së në këtë inflacionim të certifikatave profesionale për sigurinë kibernetike rrëzohet po të marrësh parasysh që kjo siguri më shumë se një sistem i ngrirë i instaluar një herë është një proces i vazhdueshëm mbrojtje të kombinuar me sisteme kompjuterike të përditësuara dhe procedura operimi dhe kontrolli. Pasi operatori ekonomik do të përfundojë furnizimin e sistemit të ri si do të veprojë AK në operimin e tij të përditëshëm? A ka AK-ja në stafin e vet, një skuadër kaq të sprovuar dhe multi-certifikuar për sigurinë kibernetike sa kjo që po kërkon në instalim?

Po të shtosh në ekuacionin e mësipërm faktin që certifikatat Ethical Hacker (CEH ose ekuivalent) janë relativisht certifikata të rralla dhe të shtrenjta, të kërkuash jo një por dy specialistë të operatorit ekonomik me këtë certifikatë kufizon shumë konkurrencën në këtë tender çka jo vetëm është kundër frymës së LPP, por është edhe kundër vetë interesave të AK së.

Si konkluzion kërkesa për të paktën 2 (dy) punonjes të certifikuar si Ethical Hacker (CEH ose ekuivalent), është në kundërshtim me LPP Neni 2, Neni 3 dhe Neni 77, dhe VKM 285, Neni 40 pasi nuk është proporcionale me objektin e kontratës. Citojmë më poshtë:

Ligji 162/2020, neni 77, “Kërkesat për kualifikim”, paragrafi 1, përcakton:

Neni 77

Kërkesat për kualifikim

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës

VKM 285, neni 40 – “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, paragrafi 3, përcakton:
Neni 40

Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

B.

Duke mos u larguar nga analiza dhe konkluzionet e mësipërme, nëse në rastin e Ethical Hacker është kërkuar të paktën një certifikim më shumë se i nevojshmi, po me të njëjtën logjikë është kërkuar në mënyrë të duplikuar dhe disproporcionalisht me objektin dhe madhësinë e kontratës së prokurimit certifikimi: për menaxhimin e sigurisë dhe riskut në sistemet e sigurisë (CRISK ose ekuivalent). Po supozojmë se bëhet fjalë për CRISK pasi ky është një standard i lartë certifikimi,

kurse certifikata cRISK është diçka me vlerë modeste dhe shumë pak e njohur. Gjithsesi AK-ja duhet ta saktësojë këtë informacion.

E gjithë bashkësia e certifikatave është e ekzagjeruar, disproporcionale me qëllimin e prokurimit por në veçanti ky ekzagjerim arrin kulmin me certifikimin CRISC, ku njohuritë për të cilat jepet kjo certifikatë janë të dublikuara dhe të treplikuara nga certifikatat e tjera që kërkohen.

Në faqen zyrtare të ISACA, organizatë që e ka krijuar dhe zotëron certifikimin CRISC (shih linkun më poshtë), përcaktohet se çfarë njohurish mbulon kjo certifikatë:

<https://www.isaca.org/credentialing/cism/cism-exam-content-outline#1>

26% DOMEN 1 – Qeverisje (organizative dhe e riskut për institucionin)

20% DOMEN 2 – Vlerësim i risqeve të IT-së

32% DOMEN 3 – Reagimi ndaj risqeve dhe raportimi

22% DOMEN 4 – Teknologjia e informacionit dhe siguria

Sikurse shikohet Domenet 1, 2 dhe 3, nuk kanë lidhje me objektin e kësaj kontrate pasi ka të bëjë totalisht me mënyrën se si është e organizuar në përgjithësi AK-ja dhe në veçanti sistemet e dhe procedurat e IT-së, planet e mitigimit të risqeve dhe mënyrat e raportimit. Operatori ekonomik është i detyruar thjeshtë ti zbatojë ato.

Domeni 4, është i vetmi që ka lidhje pjesërisht me objektin e kësaj kontrate, pasi të paktën për sistemin që OE do të instalojë duhet të zbatojë standardet e sigurisë shumë të larta që do të kërkojë AK-ja.

Por të kërkosh një certifikim ku vetëm 22% e njohurisë së tij ka lidhje pjesërisht me objektin e kontratës është disproporcionale dhe në kundërshtim me LPP-në. Për më tepër kjo njohuri është e mbuluar shumë më thellë nga 3 certifikatat e tjera që kërkohen. Madje të katër domeinet e certifikatës CRISC janë të mbulura mëse një herë nga certifikatat e tjera, sikurse e shpjegon tabela e mëposhtme me informacione të përkthyer direkt nga faqet kryesore zyrtare të institucioneve që menaxhojnë këto certifikata.

Certifikimi CRISC Certifikata të tjera të kërkuara në tender

Domeni 1 – Qeverisje (organizative dhe e riskut për institucionin)

PMP: Si autoriteti kryesor në botë për menaxhimin e projekteve, PMI krijoi Certifikimin PMP.....Certifikimi i Project Management Professional (PMP) përfaqëson një grup elitare të menaxherëve të projektit. Ai dëshmon përvojën dhe ekspertizën e udhëheqjes së projektit në çdo mënyrë pune.

Certifikimi PMP vërteton që ju jeni shumë të aftë në:

? Njerëzit: Njohja se keni aftësi për të udhëhequr dhe motivuar në mënyrë efektive një ekip projekti përgjatë një projekti.

? Procesi: Përdorimi i qasjeve parashikuese, të shkathëta dhe hibride për të përcaktuar se cila mënyrë e punës është më e mira për çdo projekt.

? Biznesi: Theksimi i suksesit të një projekti dhe ndikimi i tij në qëllimet e përgjithshme strategjike organizative.

<https://www.pmi.org/certifications/project-management-pmp?>

CISM: Qeverisja e Sigurisë së Informacionit

Ky domen ofron një pasqyrë të plotë të kulturës, rregulloreve dhe strukturës së përfshirë në qeverisjen e ndërmarrjes, si dhe mundën të analizoni, planifikoni dhe zhvilloni strategji të sigurisë së informacionit. Së bashku, kjo do të afirmojë besueshmërinë e nivelit të lartë në qeverisjen e sigurisë së informacionit për palët e interesuara. Kurikula e domenit:

A–QEVERISJA E NDËRMARRJES

Kultura Organizative;

Kërkesat ligjore, rregullatore dhe kontraktuale;

Strukturat organizative, rolet dhe përgjegjësitë;

B–STRATEGJIA E SIGURISË SË INFORMACIONIT

Zhvillimi i Strategjisë së Sigurisë së Informacionit;

Kornizat dhe Standardet e Qeverisjes së Informacionit;

Planifikimi strategjik (p.sh., buxhetet, burimet, rasti i biznesit);

<https://www.isaca.org/credentialing/cism/cism-exam-content-outline#1>

ITIL: ITIL 4 është metodologji e adaptueshme për menaxhimin e shërbimeve brenda epokës dixhitale. Nëpërmjet moduleve të praktikave më të mira, ITIL 4 ndihmon në optimizimin e teknologjive dixhitale për të bashkë-krijuar vlerë me konsumatorët, për të nxitur strategjinë e biznesit dhe për të përqafuar transformimin dixhital. ITIL 4 mund t'ju ndihmojë:

? të kuptoni se si IT ndikon në strategjinë dhe se si profesionistët mund të përdorin katër dimensionet e menaxhimit të shërbimit në një kontekst më të gjerë biznesi

? përdorni parimet udhëzuese për të lundruar në ndryshim, për të përmirësuar punën dhe për të futur praktika fleksibël dhe bashkëpunuese të punës

? thyeni kornizat duke inkurajuar një qasje holistike, sistematike për bashkëkrijimin e vlerave

? ndërtoni marrëdhënie të besueshme me palët e interesuara dhe zhvilloni komunikime efektive dhe në kohë

? punoni me sisteme komplekse, adaptive dhe procese fleksibël që mund të përshtaten me mjediset në ndryshim

? mësoni gjuhën e përbashkët të ofrimit të shërbimeve të aktivizuara me IT, për të nxitur përparimin e karrierës suaj dixhitale dhe për t'ju veçuar nga bashkëmoshatarët tuaj.

<https://www.axelos.com/certifications/itil-service-management/what-is-itil>

Domeni 2– Vlerësim i risqeve të IT-së

Domeni 3 – Reagimi ndaj risqeve dhe raportimit CISM: Menaxhimi I Rrezikut Të Sigurisë Të Informacionit

Ky domen ju fuqizon të analizoni dhe identifikoni rreziqet, kërcënimet dhe dobësitë e mundshme të sigurisë së informacionit, si dhe ju jep të gjithë informacionin në lidhje me identifikimin dhe përballimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit që do t'ju nevojiten për të kryer në nivel menaxherial. Kurikula e domenit:

A–VLERËSIMI I RREZIKUT TË SIGURISË SË INFORMACIONIT

Rreziku në zhvillim dhe peizazhi i kërcënimit;

Analiza e dobësisë së cenueshmërisë dhe kontrollit;

Vlerësimi dhe Analiza e Riskut;

B– PËRGJIGJE PËR RREZIQIN E SIGURISË SË INFORMACIONIT

Trajtimi i rrezikut / Opsionet e reagimit ndaj rrezikut;

Pronësia e rrezikut dhe kontrollit;

Monitorimi dhe raportimi i rrezikut;

<https://www.isaca.org/credentialing/cism/cism-exam-content-outline#1>

Lead- Auditor për ISO/IEC 27001

Jo vetëm njohës dhe zbatues i ISO 27001 por edhe auditues se si është zbatuar ky standard në një organizatë

Çfarë është ISO/IEC 27001?

ISO/IEC 27001 është standardi më i njohur në botë për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS). Ai përcakton kërkesat që duhet të plotësojë një ISMS.

Standardi ISO/IEC 27001 u ofron kompanive të çdo madhësie dhe nga të gjithë sektorët e veprimtarisë udhëzime për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit.

Pajtueshmëria me ISO/IEC 27001 do të thotë që një organizatë ose biznes ka vendosur një sistem për të menaxhuar rreziqet që lidhen me sigurinë e të dhënave që zotërohen ose trajtohen nga kompania, dhe se ky sistem respekton të gjitha praktikrat dhe parimet më të mira të mishëruara në këtë Standard Ndërkombëtar. .

Me krimin kibernetik në rritje dhe kërcënime të reja që shfaqen vazhdimisht, mund të duket e vështirë apo edhe e pamundur të menaxhosh rreziqet kibernetike. ISO/IEC 27001 ndihmon organizatat të ndërgjegjësohen për rrezikun dhe në mënyrë proaktive të identifikojnë dhe adresojnë dobësitë.

<https://www.iso.org/standard/27001>

Domeni 4 – Teknologjia e informacionit dhe siguria CISM: Programi i sigurisë së informacionit

Ky domen mbulon burimet, klasifikimet e asetëve dhe rregulloret për sigurinë e informacionit, si dhe ju fuqizon për të menaxhuar programet e sigurisë së informacionit, duke përfshirë kontrollin e sigurisë, testimin, komunikimin dhe raportimin dhe zbatimin. Kurikula e domenit:

A–ZHVILLIMI I PROGRAMIT TË SIGURISË TË INFORMACIONIT

Burimet e programit të sigurisë së informacionit (p.sh., njerëzit, mjetet, teknologjitë);

Informacioni Identifikimi dhe Klasifikimi i Asetëve;

Standardet dhe Kornizat e Industrisë për Sigurinë e Informacionit;

Politikat, Procedurat dhe Udhëzimet e Sigurisë së Informacionit

Metrikat e Programit të Sigurisë së Informacionit;

B–MENAXHIMI I PROGRAMIT TË SIGURISË TË INFORMACIONIT

Dizajni dhe Përzgjedhja e Kontrollit të Sigurisë së Informacionit;

Zbatimi dhe Integrimet e Kontrollit të Sigurisë së Informacionit;

Testimi dhe Vlerësimi i Kontrollit të Sigurisë së Informacionit;

Ndërgjegjësimi dhe Trajnimi për Sigurinë e Informacionit;

Menaxhimi i shërbimeve të jashtme (p.sh., ofruesit, furnizuesit, palët e treta, palët e katërta);

Programi i Sigurisë së Informacionit Komunikimi dhe Raportimi;

Menaxhimi i incidentit

Ky domen ofron trajnim të thelluar në menaxhimin e rrezikut dhe gatishmërinë, duke përfshirë mënyrën e përgatitjes së një biznesi për t'iu përgjigjur incidenteve dhe udhëzimin e rimëkëmbjes. Moduli i dytë mbulon mjetet, vlerësimin dhe metodat e kontrollit për menaxhimin e incidenteve.

A–GATISHMËRIA PËR MENAXHIMIN E INCIDENTIT

Plani i reagimit ndaj incidenteve

Analiza e ndikimit të biznesit (BIA)

Plani i vazhdimësisë së biznesit (BCP)

Plani i Rimëkëmbjes nga Fatkeqësitë (DRP)
Klasifikimi/Kategorizimi i incidenteve
Trajnim, Testim dhe Vlerësim për Menaxhimin e Incidentit

B-OPERACIONET E MENAXHIMIT TË INCIDENTIT

Mjetet dhe teknikat e menaxhimit të incidenteve

Hetimi dhe Vlerësimi i Incidentit

Metodat e frenimit të incidentit

Komunikimet e reagimit ndaj incidentit (p.sh., raportimi, njoftimi, përshkallëzimi)

Çrënjosja dhe rikuperimi i incidentit

Praktikat e rishikimit pas incidentit

<https://www.isaca.org/credentialing/cism/cism-exam-content-outline#1>

Lead- Auditor për ISO/IEC 27001

Jo vetëm njohës dhe zbatues i ISO 27001 por edhe auditues se si është zbatuar ky standard në një organizatë

ISO/IEC 27001 ndihmon organizatat të ndërgjegjësohen për rrezikun dhe në mënyrë proaktive të identifikojnë dhe adresojnë dobësitë.

ISO/IEC 27001 promovon një qasje holistike për sigurinë e informacionit: verifikimin e njerëzve, politikave dhe teknologjisë. Një sistem i menaxhimit të sigurisë së informacionit i zbatuar sipas këtij standardi është një mjet për menaxhimin e rrezikut, qëndrueshmërinë kibernetike dhe përsosmërinë operacionale.

<https://www.iso.org/standard/27001>

ITIL: Vlera e ITIL në sigurinë e sistemeve të informacionit

Menaxhimi i incidenteve

Identifikimi, parandalimi dhe zgjidhja e incidenteve është një rol parësor i një SOC, kështu që mjetet e menaxhimit të problemeve të ITIL brenda Operacioneve të Shërbimit janë jashtëzakonisht të dobishme. Pas analizës së rrezikut, udhëzimi më pas mbështet përdoruesit se si t'i qasen një ngjarjeje ose problemi nëse ndodh diçka dhe si t'i raportojnë dhe komunikojnë më gjerësisht këto rreziqe.

Pasja e këtyre proceseve të përcaktuara, së bashku me udhëzimet se si ato lidhen së bashku, e bën SOC-në tonë të funksionojë më mirë. Ai gjithashtu ndihmon në vendosjen e përsëritshmërisë dhe parashikueshmërisë në skenarë që janë shpesh të ndryshueshëm dhe potencialisht të paqëndrueshëm.

Të mësuarit nga një ngjarje

Trajtimi i një incidenti është një gjë, por për të parandaluar përsëritjen e tij është e rëndësishme të mësoni nga ajo që ka ndodhur. Me një fokus të fortë në Përmirësimin e Vazhdueshëm të Shërbimit, ITIL na jep një strukturë të qartë dhe metodike për të siguruar që ne regjistrojmë dhe veprojmë sipas mjekësisë ligjore që mbledhim pas një ngjarjeje. Në këtë mënyrë ne mund të rregullojmë mirë proceset dhe procedurat dhe të përmirësojmë atë që është tashmë në fuqi.

<https://www.axelos.com/resource-hub/blog/the-benefits-of-til-in-it-security>

Duke përmbledhur njohuritë profesionale që mbulon certifikimi CRISC, ato janë të supermbuluara

në gjerësi dhe në thellësi nga 4 certifikimet e tjera të kërkuara dhe këtu nuk kemi futur fare në llogari edhe mbivendosjen me certifikimin Ethical Hacker.

Gjithashtu vetëm 22% e kurikulës së certifikimit CRISC ka lidhje me objektin e prokurimit. I gjithë ky bombardim i jashtëzakonshëm me certifikime cybersecurity e bën kërkesën për certifikim CRISC jo vetëm disproporcional dhe në kundërshtim të fortë me LPP, por e bën edhe qesharak pasi nuk duhet të harrojmë që po flasim për një software që do të monitorojë një central elektrik lokal.

Kërkojmë

Për sa më sipër argumentuar në lidhje me kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti teknik, paragrafi 2.3.4 kërkohet:

1.1 Numri i punonjëve të certifikuar si Ethical Hacker nga 2 (dy) që është aktualisht, të zvogëlohet duke u bërë 1 (një) ose 0 (zero)

1.2 Të sqarohet nëse lloji i certifikatës që kërkohet për menaxhimin e sigurisë dhe riskut në sistemet e sigurisë është cRisk apo CRISC. Nëse është CRISC të bëhet saktësimi në dokumentet e tenderit për të shmangur çdo keqkuptim.

1.3 Nëse certifikimi i kërkuar është CRISC ose ekuivalent, atëherë kjo kërkesë duhet të hiqet nga kriteret teknike të kualifikimit

ANKESA 2

Në shtojcën 5, Formulari i Specifikimeve Teknike, paragrafi 28: Shërbime, pas shitjes dhe mirëmbajtja, përcaktohet

Një periudhë garancie duke përfshirë këtu zëvendësimin e materialeve defektoze për një periudhë prej 12 muajsh.

Furnizuesi duhet të garantojë një mirëmbajtje aftatgjatë dhe disponueshmeri të pjesëve të këmbimit. Për më tepër, një garanci duhet të paraqitet për disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit përgjatë jetëgjatësisë së sistemit SCMS.

Bazuar në këtë specifikim, operatorët ekonomik janë të detyruar të lëshojnë një deklaratë garancie për disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit përgjatë jetëgjatësisë së sistemit SCMS, dhe kostot respektive të kësaj garancie të jenë të përfshira në mënyrë implicite në ofertën ekonomike.

Vetëkuptohet që kjo garanci nuk mund të jetë me afat pafundësinë, prandaj AK-ja është në situatë e një kërkesë specifike të paqartë me impakt të rëndësishëm në ofertën ekonomike dhe si rrjedhim në shkelje të LPP.

Kërkojmë

Autoriteti Kontraktor të specifikojë se çfarë afati kohor nënkupton me “jetëgjatësi të sistemit SCMS”. Ky afat duhet deklaruar në dokumentet e tenderit dhe duhet të ketë një vlerë të arsyeshme që i përgjigjet praktikave më të mira botërore.

ANKESA 3

Në DST, shtojca 5, kapitulli 28 “Shërbime, pas shitjes dhe mirëmbajtja” kërkohet:

Furnizuesi duhet të garantojë një mirëmbajtje aftatgjatë dhe disponueshmeri të pjesëve të këmbimit. Për më tepër, një garanci duhet të paraqitet për disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit përgjatë jetëgjatësisë së sistemit SCMS.

Çfarë nënkuptohet me termin “afatgjatë”? Jetëgjatësia e sistemit mund të jetë p.sh. mbi 10 vite, a do të thotë kjo se duhet të mbahet stok për zëvendësim të pjesëve deri në 10 vite? Si është

menduar buxheti kur është konsideruar stoku për pjesët e këmbimit?

Po ashtu, nuk është parashikuar zë në preventiv për mirëmbajtjen. Si mund të ofertohet në këtë rast? Si është bere studimi i tregut?

Kërkojmë

Të detajohet:

1. Për sa kohë duhet të mbahen pjesët e këmbimit në stok?
2. A duhet të ofertohet për pjesët e këmbimit në këtë projekt apo do të kërkohet ofertë nga Autoriteti Kontraktor në momentin që do të nevojitet? Nëse duhet të merret në konsideratë oferta për pjesët e këmbimit në këtë projekt, për sa vite operimi të pajisjeve duhet të konsiderohen pjesët e këmbimit?
3. A do të ofertohet për mirëmbajtjen në këtë projekt? Nëse po:
 - a. Për sa vite kërkohet mirëmbajtja?
 - b. Të shtohet në preventiv mirëmbajtja

ANKESA 4

Në DST, shtojca 5, kapitulli 29 “Dokumentacioni”, paragrafi 1.1 Pajisje Industriale (Server), kërkohen specifikimet e serverit industrial si më poshtë:

Industrial Rack Mount PC - (2 x Copë)

Dezajni mekanik Rack PC, 19 , 2U

Montim ne RACK 19 2U Po

Burimi i ushqimit AC/DC

Tipi i burimit te ushqimit Dy burime te vecanta ushqimi dhe redundante

Tensioni i burimit te ushqimit VAC 100?240 50/60 Hz dhe VDC 100?250 PD = 700W

Frekuenca e linjes

Vlera e frekuences nominale 50/60 Hz

Kapaciteti ruajtjes së ushqimit

Koha ruajtjes se ushqimit ne mungese te tensionit = 20 ms

Tipi i processorit 14000 Pikë

Karta Grafike Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Minimum 8 GB GDDR6 dedicated Memory; Min. (2) Porta (VGA/DVI/HDMI/DP, mund të përdoret dhe adaptor). Karta të jetë e rekomanduar dhe instaluar nga prodhuesi për workstation.

Hard disk 2x 1000 GB 2.5 SATA SSD NVMe = ose ekuivalent

Memorje SSD Po

Tipi i konfigurimit te memorijes SSD HW RAID 1

Lloji i memorjes RAM DDR4

Madhesia e memories RAM 32 GB, min. DDR4 2666 MHz, ECC

Konektore ne bord (slots)

Tipi i konektoreve = 4 slots: 2x PCI (x16), 2x PCIe Express 3.0 (x16)

Numri i konektoreve total = 6 total ports

Porta USB = 2x USB 3.0: 2 ne pjesen frontale;

= 4x USB 2.0: ne pjesen e pasme.

Serial Port = 1x RS 232

PROFIBUS/MPI Mund te implementohet me plug-in card

Industrial Ethernet 100/1000Mbps = 3x Gigabit Ethernet (IE/PN), RJ45

Funksione monitoruese

Monitorimi i temperatures Po

Indikacione te gjendieve në LED POWER, HDD Alarm, FAN , Ethernet Ports, Watchdog,

Monitorim i ventilatorit Po

Monitorim me ane te rrjetit Po (me IPMI)

Funksione te tjera

Zevendesimi i HDD dhe PSU gjatë operimit Po (Hot plugin)

Zevendesimi i ventilatoreve/filtrave te ajrit /pa patur nevoj veglash Po (Removable Frame)

Imunitetit ndaj interferencave te shkaktuara nga shkarkimet e ngarkesave elektrostатike

Imuniteti kundrejt interferencave te shkarkimit të energjisë elektrike statike?4 kV contact discharge acc. to IEC 61000-4-2; ?8 kV air discharge acc. to IEC 61000-4-2

Imunitetit ndaj interferencave te shkaktuara nga fushat elektromagnetike me frekuence te larte

Imuniteti kundrejt interferencave te rrezatuara në frekuencë të lartë 10 V/m for 80 - 1 000

MHz, 80% AM acc. to IEC 61000-4-3; 3 V/m for 1.4 - 2 GHz, 80% AM acc. to IEC 61000-4-3; 1

V/m for 2 - 2.7 GHz, 80% AM acc. to IEC 61000-4-3; 10 V for 150 kHz - 80 MHz, 80% AM acc. to IEC 61000-4-6

Imunitetit ndaj interferencave te shkaktuara prej kablllove elektrik

Imuniteti kundrejt interferencave ne kabllot e furnizimit ?2 kV acc. to IEC 61000-4-4, burst; ?1

kV acc. to IEC 61000-4-5, surge symmetric; ?2 kV acc. to IEC 61000-4-5, surge asymmetric

Imuniteti kundrejt interferencave ne kabllot e sinjalit = 30m ?2 kV acc. to IEC 61000-4-4,

burst; ?2 kV acc. to IEC 61000-4-5, surge

Imuniteti kundrejt interferencave ne kabllot e sinjalit = 30m ?1 kV acc. to IEC 61000-4-4,

Burst

Imuniteti ndaj interferencave te shkaktuara prej mbi ngarkesave (ose mbi tensioneve)

Interferenca te shkaktuara nga asimetrите ?2 kV acc. to IEC 61000-4-5, surge asymmetric

Interferenca te shkaktuara nga simetrите ?1 kV acc. to IEC 61000-4-5, surge symmetric

Imuniteti ndaj interferencave te fushave elektromagnetike

Imuniteti ndaj interferencave të fushave elektromagnetike 100 A/m; to IEC 61000-4-8

Emisionet e shkaktuara nga siperfaqet perciellese dhe je perciellese

Emetimi i injektuar përmes kablllove të rrymës se linjes se ushqimit AC /DC EN 61000-6-3,

FCC Class A, EN 61000-6-4, CISPR 22, EN 55022 Class B, EN 61000-3-2 Class D, EN 61000-3-3

Pajtueshmeria kundrejt standarteve :

IP (ne pjesen ballore) IP30

IP (ne pjesen e mbrapme) IP20

Kompatibel kundrejt CE Po; Për përdorim në mjedise industriale, (EN 61000-6-3:2007

+A1:2011, imunitet ndaj zhurmave: EN 61000-6-2:2005)

Aprovimi nga CSA Po

Aprovimi cULus Po

Aprovimi FCC Po

Aprovimi EMC CE, EN 61000-6-3:2007 +A1:2011, EN 61000-6-2:2005

Mbrojtja kundrejt pluhurave dhe ndotesve te tjere partikularë G2 EN 779, 99% te grimcave >

0.5 ?m jane te filtruara

Temperatura e Ambientit gjate operimit

Temperatura e ambientit e lejuar gjate operimit 0 to +50?C

Temperatura e Ambientit gjate magazinimit (prezervimit)

Temperatura T?min. -20?C

Temperatura T?max. 60?C

Lageshtira relative

Lageshtira relative Testuar sipas IEC 60068-2-78, IEC 60068-2-30: Operim: 5 % to 85 % at 30

?C (jo kondesuese), perzervim / transport: 5 % to 95 % at 25 / 55 ?C (jo kondesuese)

Stabiliteti kundrejt vibrimeve

Rezistenca kundrejt vibrimve gjate operimit sipas t IEC 60068-2-6Testuar sipas IEC 60068-2-6, 10

cycles; 20 to 58 Hz: 0.015 mm; 58 to 200 Hz: 2 m/s? (0.2 g)

Testimi kundrejt goditjes

Testimikundrejt goditjes gjate operimit Testuar sipas IEC 60068-2-27; half-sine: 9.8 m/s? (1 g),

20 ms, 100 shocks per axis

Sistemi i instaluar

Windows 10 2019 LTSC/Windows Server 2019 Po

Dimensionet
Gjersi
Lartesi 2U
Thellesi

Referuar kërkesave të mësipërme, pajisja e vetmë që përmbush 100% kërkesat është nga prodheusi Siemens.

Referenca: <https://mall.industry.siemens.com/mall/sv/se/Catalog/Products/10289743>

Kjo pengon konkurrencën e lirë duke lejuar vetëm një prodhues të vetëm (Siemens) që të jetë opsion për ofertim në këtë projekt. Çfarë prodhuesish të tjerë sygjeron Autoriteti Kontraktor për ekuivalencë të serverit industrial? Përse është e nevojshme që karakteristikat e serverit të jenë 100% si ato të modelit të mësipërm Siemens? Funksionin e kërkuar në projekt mund ta realizojë çfarëdo modeli tjetër nga prodhues të tjerë. A mos kërkon AK që të ofertohej vetëm nga një operator i vetëm që mund të ofertojë Siemens?

Kërkojmë

Të ndryshohen specifikimet teknike të pajisjes server industrial që kërkohet në projekt duke bërë që të lejohet ofertimi edhe nga prodhues të tjerë përveç Siemens. Minimalsiht të hiqen termat që përdoen vetëm nga Siemens dhe prodheusit e tjerë nuk kanë ekuivalensë, si p.sh. PROFIBUS/MPI etj.

Ose të listohen të paktën 2 modele nga prodhues të tjerë që përmbushin specifikimet teknike të kërkuara nga AK për server industrial, duke mundësuar konkurrencën e lirë në këtë ofertim.

ANKESA 5

Në DST, shtojca 5, kapitulli 29 “Dokumentacioni”, paragrafi 1.2 Workstation Operatori, listohen kërkesat teknike të workstation:

Industrial Rack Mount PC - (2 x Copë)

Dezajni mekanik Rack PC, 19 , 4U

Montim ne RACK 19 4U Po

Burimi i ushqimit AC/DC

Tipi i burimit te ushqimit Digital power supply to support IPMI FRU

Tensioni i burimit te ushqimit VAC 90-264 V 50/60 Hz dhe VDC 100 - 240 V PD = 800Ë

Frekuenca e linjes

Vlera e frekuences nominale 50/60 Hz

Kapaciteti ruajtjes së ushqimit

Koha ruajtjes se ushqimit ne mungese te tensionit = 20 ms

Tipi i processorit 14000 Pikë

Karta Grafike Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Minimum 8 GB GDDR6 dedicated Memory; Min. (2) Porta (VGA/DVI/HDMI/DP, mund të përdoret dhe adaptor). Karta të jetë e rekomanduar dhe instaluar nga prodhuesi për workstation.

Hard disk 2 x 960GB SSD 2.5 SATA NVMe =

Memorje SSD Po

Tipi i konfigurimit te memorijes SSD HW RAID 1 (2 x 960GB SSD 2.5 SATA) =

Lloji i memorjes RAM DDR4 - SDRAM DIMM

Madhesia e memories RAM 32 GB, min. DDR4 2666 MHz, ECC

Konektore ne bord (slots) = 4 slots:

Tipi i konektoreve = 2x PCI (x16), 2x PCIe Express 3.0 (x16)

Numri i konektoreve total = 6 total ports

Porta USB = 2x USB 3.0: 2 ne pjesen frontale;

= 4x USB 2.0: ne pjesen e pasme.

Industrial Ethernet =2x 100/1000 MBit/s
 Funksione monitoruese
 Monitorimi i temperatures Po (Alarm and Shutdown)
 Indikacione te gjendieve në LED Power, Ethernet, Temp, Fan, HDD1 Alarm, HDD0 Alarm
 Monitorim i ventilatorit Po
 Monitorim me ane te rrjetit Po (me IPMI)
 Funksione te tjera
 Zevendesimi i HDD dhe PSU gjatë operimit Jo (Hot plugin)
 Zevendesimi i ventilatoreve/filtrave te ajrit Po (Removable Frame)
 Temperatura e Ambientit gjate operimit
 Temperatura e lejuar gjate operimit 10 to +35°C
 Lageshtira relative
 Lageshtira relative Operim: 5 % to 85 % at 30 °C (jo kondesuese), perzervim / transport: 5 % to 95 % at 25 / 55 °C (jo kondesuese)
 Dimensionet
 Gjersi
 Lartesi 4U
 Thellesi

Referuar kërkesave të mësipërme, pajisja e vetmë që përmbush 100% kërkesat është nga prodhuesi Siemens.

Referenca: <https://mall.industry.siemens.com/mall/en/WW/Catalog/Products/10398841>

Kjo pengon konkurrencën e lirë duke lejuar vetëm një prodhues të vetëm (Siemens) që të jetë opsion për ofertim në këtë projekt. Çfarë prodhuesish të tjerë sygjeron Autoriteti Kontraktor për ekuivalencë të workstation? Përse është e nevojshme që karakteristikat e workstation të jenë 100% si ato të modelit të mësipërm Siemens? Funksionin e kërkuar në projekt mund ta realizojë çfarëdo modeli tjetër nga prodhues të tjerë. A mos kërkon AK që të ofertohej vetëm nga një operator i vetëm që mund të ofertojë Siemens?

Kërkojmë

Të ndryshohen specifikimet teknike të pajisjes workstation që kërkohet në projekt duke bërë që të lejohet ofertimi edhe nga prodhues të tjerë përveç Siemens.

Ose të listohen të paktën 2 modele nga prodhues të tjerë që përmbushin specifikimet teknike të kërkuara nga AK për workstation, duke mundësuar konkurrencën e lirë në këtë ofertim.

ANKESA 6

Në DST, shtojca 5, kapitulli 29 “Dokumentacioni”, paragrafi 1.4 SWITCH INDUSTRIAL, kërkohet që modeli i switch të jetë Ruggedcom RSG2100 ose ekuivalent. Ndërkohë që ky model switch-i i prodhuesit Siemens nuk ka asnjë model ekuivalent të ndonjë prodhuesi tjetër që plotëson 100% specifikimet. Kjo pengon konkurrencën e lirë duke lejuar vetëm një prodhues të vetëm (Siemens) që të jetë opsion për ofertim në këtë projekt. Çfarë prodhuesish të tjerë sygjeron Autoriteti Kontraktor për ekuivalencë të switch-it Ruggedcom RSG2100? Përse është e nevojshme që karakteristikat e switch të jenë 100% si ato të modelit të mësipërm Siemens? Funksionin e kërkuar në projekt mund ta realizojë çfarëdo modeli tjetër nga prodhues të tjerë. A mos kërkon AK që të ofertohej vetëm nga një operator i vetëm që mund të ofertojë Siemens?

Kërkojmë

Të ndryshohen specifikimet teknike të pajisjes switch industrial që kërkohet në projekt duke bërë që të lejohet ofertimi edhe nga prodhues të tjerë përveç Siemens. Ose të listohen të paktën 2 modele nga prodhues të tjerë që përmbushin specifikimet teknike të kërkuara nga AK për switch industrial.

ANKESA 7

Në DST, shtojca 5, kapitulli 29 “Dokumentacioni”, paragrafi 1.5 GPS, kërkohet sistemi GPS me kërkësat si më poshtë:

GPS Synchronization device 1x Copë

Characteristics NTP Time Server - GPS radio clock

Type of receiver 6 channel GPS C/A-code receiver

Type of antenna Remote powered GPS antenna/converter unit, up to 300m distance to antenna with:

RG58 and up to 700m distance with RG213 cable

Display LC-display, 2 x 40 characters, with backlight

Control elements Eight push buttons to set up basic network parameters and to change receiver settings

Status info Four bicolor LEDs showing status of:

- reference time
- time service
- network
- alarm

Frequency outputs 10 MHz via female BNC connector, TTL into 50 Ohm

Pulse outputs Pulse Per Second (PPS), TTL level, pulse width: 200ms

Interface Independent serial RS232-interfaces, menu configurable

Data format of interfaces Baud rates: 1200, 2400, 4800, 9600, 19200 Baud

Data formats 7N2, 7E1, 7E2, 7O1, 8E1, 8N1, 8O1

Alarm output Synchronous state of the module, relay output (changeover contact)

Lan Network Interface Standard: 4 x 10/100 MB with RJ45 connector

Additional Requirements 2 x additional 10/100 MBit with RJ45

1 x 10/100 MBit and 1 x 10/100/1000 MBit (1GE) with RJ45 or

1 x 10/100 MBit and 3 x 10/100/1000 MBit (3GE) with RJ45 jack

Power supply Input Voltage DC: 100-240 VDC,(Umax = 90-250 V DC) Redundant power supply configuration.

Power consumption 20W

Universal Serial Bus (USB) Port: 1x USB Port in front panel:

- install firmware upgrades
- backup and restore configuration files
- copy security keys
- lock/unlock front keys

Supported Time String Meinberg Standard Timestring, Uni Erlangen Timestring, SYSPLEX Timer, NMEA,

Formats Computime, ABB-SPA, SAT, Arbiter

Processor Highest standart available or i386 compatible 500Mhz CPU, 128 MB RAM

Operating System of the SBC Linux with nano kernel (incl. PPSkit)

Network protocols OSI TCP, UDP

Layer 4 (transport layer)

Network protocols OSI TELNET, FTP, SSH (incl. SFTP, SCP), HTTP, HTTPS, SYSLOG, SNMP

Layer 7 (application layer)

Internet Protocol (IP) IP v4, IP v6

Network Autoconfiguration IPv4: Dynamic Host Configuration Protocol - DHCP (RFC 2131)

IPv6: Autoconfiguration Networking - AUTOCONF

Support

Network Time Protocol NTP v2 (RFC 1119), NTP v3 (RFC 1305), NTP v4 (no RFC) SNTP v3 (RFC 1769), SNTP v4 (RFC 2030)MD5 Authentication and Autokey Key Management (NTP)

IEC 61850 Protocol Synchronization of IEC 61850 compliant devices by using SNTP
Hypertext Transfer Protocol HTTP/HTTPS (RC 2616)
(HTTP)
Secure Shell (SSH) SSH v1.3, SSH v1.5, SSH v2 (OpenSSH)
Telnet Telnet (RFC 854-RFC 861)
Simple Network Management Protocol (SNMP) SNMPv1 (RFC 1157), SNMPv2c (RFC
1901-1908), SNMP v3 (RFC 3411-3418)
Form Factor 19 inch multipac metal case 1U/84HE
Ambient temperature 0 ... 50°C / 32 ... 122°F
Main functions NTP and SNTP Synchronization
Web-based status and configuration interface as well as console-based graphical
configuration tools.

Nisur nga kërkesat më sipër është e qartë se produkti i përket modelit Meinberg LANTIME
M300/GPS, 19 rack, referenca:

<https://www.adeptor.no/meinberg/m300-slash-gps-slash-wa/meinberg-lantime-m300-gps-19-rack-antenna-and-cable-not-included>

Nisur nga shumë terma të cilat i referohen vetëm prodhuesit Mineberg, siç është Meinberg
Standard Timestring, nuk ka asnjë model nga prodhues të tjerë që përmbush 100% specifikimet.
Kjo ul konkurrencën e lirë për ofertim nga prodhues të ndryshëm.

Kërkojmë

Të ndryshohen specifikimet teknike të pajisjes GPS që kërkohet në projekt duke bërë që të lejohet
ofertimi edhe nga prodhues të tjerë përveç Mineberg. Ose të listohen të paktën 2 modele nga
prodhues të tjerë që përmbushin specifikimet teknike të kërkuara nga AK për GPS.

ANKESA 8

Në DST, shtojca 5, kapitulli 29 “Dokumentacioni”, paragrafi 1.7 Inverter, listohen kërkesat teknike
të Inverterit:

Nisur nga sa më sipër është e qartë se prodhuesi i vetëm që përmbush 100% specifikimet teknike
është Eltek.

Referenca: <https://www.eltek.com/products/rectiverter-230v1500va-220v1200w/>

Nuk ka asnjë prodhues tjetër që përmbush specifikimet dhe kjo ul konkurrencën e lirë në treg për
të ofertuar nga prodhues të tjerë, dhe duke diskriminuar një gamë të gjerë prodhuesish profesionalë
në pajisjet Inverter për të qenë pjesë e zgjidhjes për këtë projekt. Përse është e rëndësishme për AK
që të ofertohej vetëm prodhuesi Eltek? A nuk mund ta kryejë funksionin çfarëdo prodhuesi
Inverter për kërkesat që ka AK? Patjetër që ka edhe modele inverterash nga prodhues të ndryshë,
me kërkesa minimale që mund të realizojnë kërkesat e AK.

Kërkojmë

Të ndryshohen specifikimet teknike të pajisjes Inverter që kërkohet në projekt duke bërë që të
lejohet ofertimi edhe nga prodhues të tjerë përveç Eltek. Ose të listohen të paktën 2 modele nga
prodhues të tjerë që përmbushin specifikimet teknike të kërkuara nga AK për Inverter.

ANKESA 9

Në DST, shtojca 5, kapitulli 7 “Set fibrash optike”, kërkohet:

Setet e fibrave optike do të përzgjidhen në varësi të portës së releve dhe të portës së Switch-eve
optike. Setet e fibrave duhet të mundësojnë lidhjen e të gjitha releve në Switch-et optike dhe
ndërmjet tyre.

Infrastuktura e komunikimit duhet të jetë e bazuar në fibra optike për komunikimin me switchet
dhe paisjet e tjera sic përshkruhet në kapitujt vijues sipas topologjisë së përcaktuar të rrjetit IEC
62439-3 : 2016.

Por nuk jepet informacion mbi topologjinë e rrjetit. Sa janë distancat për lidhjen e releve në

switch-et optike? Si do të përlogaritet sasia e nevojshme e fibreës dhe aksesorëve të nevojshëm për lidhjen e releve? Si është bërë studimi i tregut për nxjerrjen e buxhetit?

Kërkojmë

Kërkohej që të jepet në mënyrë të detajuar topologjia e rrjetit të nënstacionit duke detajuar kërkesat për gjatësitë e fibrave optike që do të shërbejnë për lidhjen e releve në switch-et e fibrës.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

JO

7. Lista e informacionit konfidencial:

JO

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

a.frangu@b360.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Armand Frangu